



Policia jep detaje nga grabitja në Prishtinë



04/05/2023 15:24



Një grabitje e armatosur ka ndodhur në mes të ditës në Prishtinë. Grabitja ka ndodhur në një institucion mikrofinanciar në kryeqytet.

Lidhur me këtë rast në një përgjigje për lajmi.net nga Policia e Kosovës kanë dhënë detaje lidhur me rastin.

“Sot rreth orës 14:00 është raportuar për një grabitje të ndodhur në një institucion mikrofinanciar në rrugën “Nazim Gafurri” në Prishtinë. Pas marrjes së informacionit policia ka dalë në vendngjarje dhe bazuar në informacionet e para, dyshohet se një personi i dyshuar nën kërcënim të armës ka grabitur një shumë parash. Policia ka iniciuar një hetim lidhur me rastin dhe ka nisur me ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme policore me qëllim zbardhjen e rrethanave të rastit si dhe identifikimin dhe arrestimin e personit të dyshuar”, thonë nga Policia e Kosovës.

Lajmi.net ka mësuar nga dëshmitarët e rastit, të cilët nuk kanë dashur të prononcohen para kamerës, se në filialin mikrofinanciar kishte hyrë vetëm një person i armatosur me revole.

I njëjti është larguar menjëherë nga vendi i ngjarjes, ndërsa nuk dihet shuma te cilën ka arritur ta grabisë.

I dyshuari ka shkaktuar shqetësim dhe frikë tek punonjësja që ishte duke punuar në filialin mikrofinanciar, duke bërë kështu që në vendin e ngjarjes të dalin edhe ekipet mjekësore. /**Lajmi.net**/

Artikuj të ngjashëm



May 5, 2023

Anëtari i VV-së kritikon krerët e shtetit që po “derdhin lot”...



May 5, 2023

Arrestohet i dyshuari që tentoi të grabis një institucion mikrofinanciar dhe...



May 5, 2023

Konjufca shpreh ngushëllime për dy rastet tragjike në Serbi



May 5, 2023

Krerët e shtetit bëjnë homazhe në “Varrezat e Dëshmorëve” për 5...



May 5, 2023

Kërkohet rishikimi i aktakuzës për infermierët që sulmuan të moshuarën në...



May 5, 2023

Osmani në Mbretërinë e Bashkuar për Kurorëzimin e Mbretit Charles III



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr. 5

Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information

RRJETET SOCIALE

